



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi / Prodhuesi Received / Delivered	22. 01. 2024	5	viti god year
Organ / Rjeshta Organ / Jednica Org / Unit	SHKIPARSKA	400/2024	119
Hi Prot Hi Prot Prot No		Shtypja Printed Appendix	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1443/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare; Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1443/2023, të datës 27.11.2023, të parashtruar nga ankuesi me adrese në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1443/2023, e datës 27.11.2023, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.32/2023, i datës 29.08.2023, i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me datë 11.07.2023 (afati për aplikim 01.08.2023-09.08.2023) ka shpallur konkursin e jashtëm për pranim me numër të referencës RN0001204, për emrin e grupit " Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetësisë/Mjekësisë", titulli i vendit të punës *Inspektorë Shëndetësor*, në Ministrinë e Shëndetësisë, klasa profesional 1, 25 vende pune, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi përmes aplikacionit, të datës 08.08.2023.

Tutje, ankuesi sipas Vendimit Nr.44/2023 të datës 21.08.2023 të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, nuk është përfshirë në listën e ngushtë për të vazhduar në fazën tjetër të procedurës për pozitën përkatëse të punës, me arsyetimin se i njëjti nuk ka ofruar dëshminë e kërkuara sipas konkursit: *pasqyren e pagave per fondin e kursimeve pensionale, pasqyren e pagesave te obligimeve tatimore ne perputhje me legjislacionin tatimor per te ardhura personale.*

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin Nr.44/2023 të datës 21.08.2023, ka parashtruar ankesë (pa datë dhe numër) pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa, kjo e fundit me Vendimin me numër Nr.32/2023, të datës 29.08.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën me arsyetimin e njëjtë së ankuesi nuk ka ofruar dëshmitë sipas konkursit, përkatësisht: *pasqyren e pagave per fondin e kursimeve pensionale, pasqyren e pagesave te obligimeve tatimore ne perputhje me legjislacionin tatimor per te ardhura personale, prandaj pala nuk i përmbush kushtet për përfshirjen në listën e ngushtë.*

Departamenti për Menaxhimin e zyrtarëve Publik me datën 01.11.2023 përmes sistemit elektorik ka lajmëruar ankuesin se janë publikuar rezultatet përfundimtare të vlerësimit për shpalljen me numër referencë RN00012041 në SIMBNJ, dhe se kandidatet e pa kënaqur ndaj rezultatit të konkurimit kanë të drejtë të parashtrorin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Kundër Vendimit Nr.32/2023, të datës 29.08.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ankuesja, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Thëkson së me rastin e aplikimit i njëjti i ka përmbushur kushtet e konkursit pasi që ka përfunduar punë rreth dy vjetë në njërin nga klinikat me prestigjioze në Ferizaj të cilën e dehequr edhe me vërtetimin e leshuar nga kjo klinike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vërtetimit të Ankesave, me datë 04.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa, ky i fundit me datë 06.12.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vërtetimin e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7102/2023 të datës 27.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vërtetimin e datës 22.11.2023; Plotësimin e ankesës të datës 29.11.2023; Vendimin me Nr.44/2023 të datës 21.08.2023; Ankesën pa datë dhe numër; Vendimin me Nr. 332/2023 të datës 29.08.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.12.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 06.12.2023; Konkursin e datës 11.07.2023; Vendimin me numër 02/161 të datës 25.09.2023; Listën e aplikanteve të datës 21.08.2023; Njoftimin e datës 29.08.2023; Aplikacionin e datës 08.08.2023; Diplomën me numër 00708-S të datës 25.7.2019; Sumplimentin e Diplomës të datës 07.07.2020; Certifikatën e notave me numër 700 të datës 07.07.2020; Vërtetimin me numër 26 të datës 26.07.2019; Licencën e punës të datës 05.08.2021; Deklaratën e datës 017.08.2023; Shkresën e datës 22.02.2020; Dokumentin e identifikimit; CV; Certifikatën Shëndetësore të datës 04.08.2023; Certifikatën e datës 14.07.2021; Certifikatën me numër i/4982 të datës 11.03.2016; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 04.08.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vërtetimin e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës konstatoi së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:* Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar Konkursin për grupin *Specialistë i Përgjithshëm i Shëndetësisë /Mjekësisë për pozitën "Inspektor Shëndetësor"* dhe si pasojë si kërkesa të përgjithshme formale për këtë pozitë të punës janë përcaktuar:



- *Arsimi i kërkuar*: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në fushat; Mjekësi e Përgjithshëm, Mjekësi Tjetër dhe Menaxhim Mjekësore;
- *Kualifikime të posaçme formale*: Licenca pre ushtrim të pavarur të veprimtarisë shëndetësore;
- *Përvoja e punës e kërkuar*: Se paku (2) vite përvoja pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës;

Ndërsa, sipas pikës 7 të konkursit, dokumentacione për aplikim janë specifikuar: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin apo aktin që dëshmon se diploma e marrë jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit*; • *Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale (vërejtje: nuk vlen vetëm vërtetimi dhe apo vetëm dokumenti mbështetës, është i nevojshëm ngarkimi në sistem i të dy llojeve të dokumenteve: vërtetimi si dëshmi kryesore dhe njëra nga pasqyrat si dëshmi mbështetëse)*; Nuk kërkohet dëshmi mbështetëse për përvojën e punës në sektorin publik. • *Kopjen e licencës për ushtrim të pavarur të veprimtarisë shëndetësore*; • *Kopjet e dëshmisë së trajnimeve të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit. Njëra nga këto dokumente është e mjaftueshme*; • *Dëshmi përkatëse se kandidati/ja ka zotësi të plotë për të vepruar (prezantohet nga kandidati/ja nëse ai/ajo përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatin e arritur)*; • *Dëshmi mjekësore se kandidati/ja është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryerjen e detyrës (prezantohet nëse kandidati/ja përzgjidhet për emërim. Dëshmia duhet të jetë jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj)*; • *Certifikatë/vërtetim nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit*; • *Kualifikime të posaçme formale: licencë për ushtrim të pavarur të veprimtarisë shëndetësore*; • *Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar e punës, është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilin dëshmohet se ai/ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L – 114 për Zyrtarët Publik*; • *Nëse përvoja e punës e deklaruar është në: sektorin privat brenda apo jashtë vendit, në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës është ndonjë formë e marrëdhënies kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vetë deklaram i nënshkruar se ai/ajo, nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L – 114 për Zyrtarët Publik.*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi me rastine aplikimit në konkursin e datës 11.07.2023 për grupin specialist i Përgjithshëm i Shëndetësisë / Mjekësisë për pozitën e punës Inspektor i Shëndetësisë lidhur me plotësimin e kriterit të kualifikimit arsimor, ka dorëzuar Diplomën me Nr.00708-S, të datës 03.10.2019 me të cilën vërtetohet se i njëjti me datë 25.07.2019, ka marrë titullin "Master i Shkencave në Stomatologji" se i njëjti ka plotësuar kriterin e vendosur në aspektin e kualifikimit arsimor. Ndërsa, sa i përket kriterit të përvojës së punës ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi, as vërtetim të leshuar nga organi i punësimit e as pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale ose pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, përvoja e punës në sektorin privat duhet të dëshmohet me pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale ose pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale si dhe duhet të jete e shoqëruar edhe me vërtetim/dëshmi/ apo anasjelltas nga punëdhënësi që specifikon edhe detyrat gjegjësisht angazhimin e tij tek biznesi privat, standard ky tashme i vendosur nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, dhe i vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit e Kosovës, sipas



Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës.

Për sa me sipër dhe duke qenë se nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesi me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës, nuk e ka ofruar dëshmi të vlefshme lidhur me përvojën e punës te kerkuar sipas konkursit të datës 11.07.2023 gjegjësisht në pikën 7 ku është percaktuar se; *Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale (vërejtje: nuk vlen vetëm vërtetimi dhe apo vetëm dokumenti mbështetës, është i nevojshëm ngarkimi në sistem i të dy llojeve të dokumenteve*". Andaj, Kolegji i Këshillit vlerëson se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ka vërtetuar drejtë gjendjen e fakteve dhe ka zbatuar drejt ligjin material me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.44/2023 të datës 21.08.2023 dhe Vendimit Nr.32/2023, të datës 29.08.2023, duke vepruar kështu në pajtim me nenin 15 paragrafët 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet së: 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë. Andaj pretendimet ankimore te ankuesit lidhur me dorëzimin e përvjes së punës me rastin e aplikimit në konkursin me numer Reference RN00012041 të datës 11.07.2023 për grupin Specialit të Përgjithshëm të Shëndetësis/Mjekësis janë të pa bazuara.

Theksuar si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1443/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.